# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-458681**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Eksperti: Ja si politikanët shqiptarë bënë një gabim fatal me ngritjen e Gjykatës Speciale - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/eksperti-ja-si-politikanet-shqiptare-bene-nje-gabim-fatal-me-ngritjen-e-gjykates-speciale/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 19:42:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 19:40:37 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c127b20d69b68e8c4a1535947c2e29905b044f64a0baed50554cd79b1b69a347` |
| TEKSTI | `abc266e8e7bbbd8125050b0f5d003342fd98f1b74bd573dceb288179e08cf88f` |
| PAMJA | `ab5288c13a8c0c5f1d3c320a8f055c6e4526993c528a7a9ec27cf22587961154` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `79969f8b2375eda3eb1ec2cbc09559af56d355da3567de350fc2ad9421d532d1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `236eb96fe169b4692e142b22588aed50ca0b168d3e0d8d3c079cd404682cbd2f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/79969f8b2375eda3eb1ec2cbc09559af56d355da3567de350fc2ad9421d532d1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT

# Eksperti: Ja si politikanët shqiptarë bënë një gabim fatal me ngritjen e Gjykatës Speciale

19 Shtator 2026 | 21:40

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

I ftuar në emisionin “Review” me Greta Topjanën, eksperti i çështjeve ndërkombëtare, Marlind Laçi, foli në lidhje me dënimin e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Gjykata Speciale. Laçi e cilësoi vendimin si një dënim ndaj asaj që ai e quan “institucioni i lirisë së shqiptarëve”, ndërsa kritikoi mënyrën se si u krijua Gjykata Speciale dhe votimin e ndryshimeve kushtetuese në Kosovë.

Sipas Laçit, përgjegjësia për krijimin e kësaj gjykate bie mbi politikanët shqiptarë që e votuan. Ai argumentoi se vendimi mund të përdoret nga Serbia për të demonizuar rezistencën shqiptare, por theksoi se, pavarësisht kësaj, ekzistenca e Kosovës nuk vihet në rrezik.

“Me këtë dënim u dënua institucioni i lirisë së shqiptarëve, një institucion që luftoi pragun në shtëpisë së vet, rezistoi ndaj armikut. Dhe forma si u ngrit kjo gjykatë në vitin 2015 dhe forma si u ndërmorën ndryshimet kushtetuese ishte gabim fatal edhe për liderët që janë në Hagë, përveç Rexhep Selimit, i cili luftoi që këto ndryshime të mos votoheshin. Një gabim i rëndë, fatal për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, pasi duam apo s’duam, ne, siç e kemi gjatë gjithë kohës, dimë që UÇK-ja është institucioni i lirisë dhe ka një dëm të jashtëzakonshëm nga ky vendim i gjykatës. Forma si u formua kjo gjykatë, forma sesi zoti Thaçi u shpreh që ‘ai që s’e voton Gjykatën Speciale s’e do Kosovën’, forma se si Tirana zyrtare u soll, ku të gjithë faktorët politikë, qoftë Rama dhe Berisha, kanë qenë pro krijimit të kësaj gjykate, duke u justifikuar me presionin ndërkombëtar. Që të jesh nën presion duhet të kesh bërë diçka që ndërkombëtarët ta përdorin. Nuk shantazhohet dikush që s’ka bërë gjë. Në perceptimin e politikanëve shqiptarë, çfarë vjen nga ndërkombëtarët është e mirë dhe në këtë rast edhe Krasniqi dhe Veseli i perceptonin si të mira propozimet e ndërkombëtarëve, ndërsa zoti Kurti u kërkonte bojkotimin e kësaj seance. Politikanët shqiptarë e konsiderojnë marrëdhënien me ndërkombëtarët si diktat: ndërkombëtarët flasin, ne zbatojmë. Në rastin e Gjykatës Speciale, që në gjykimin tim ka dhe një emër që të kujton Gjykatën e Inkuizicionit, është hera e parë dhe e paprecedentë që një gjykatë dënon viktimën dhe s’merren me agresorin. Kjo duhet të dënonte Serbinë, siç u dënua Gjermania naziste. Serbia ka kryer gjenocid, qoftë në Bosnjë, në Srebrenicë e në Kosovë. Është e padëgjuar ndonjëherë që një shtet që ka pësuar gjenocid, udhëheqësit e rezistencës së vendit të tyre të ndodhen prapa hekurave me 81 vite burg, dënim maksimal dhe aspak të mëshirshëm. Serbisë i shërben precedenti për të demonizuar kryengritjen shqiptare. Janë 64 deputetë shqiptarë që kanë votuar pro kësaj Gjykate Speciale, me emra me peshë si Enver Hoxha e Vjosa Osmani, që në gjykimin tim duhet të tërhiqen nga politika si njerëz pa vizion dhe pa largpamësi. Ndryshimi i madh është që pjesa e opozitës së djeshme dhe pozitës së sotme kanë qenë në frontin e parë në kundërshtim me këtë gjykatë dhe janë videot me zë dhe

## LAJMI I FUNDIT

21:21 **Dënimi i krerëve të UÇK-së, Çipa: Proces politik, vendimi të lexohet nga të gjithë faktorët shqiptarë**

21:05 **Vendimi i Hagës, asist për Vuçiçin, Buzhala: Serbia do të nisë fushatë për tërheqjen e njohjeve të Kosovës**

20:49 **Buzhala: Gërvalla deklaronte se do të depozitonte fakte në Hagë, heshtja e saj pas vendimit është e pazakontë**

20:24 **Ylljet Aliçka “Qytetar Nderi” i Kolonjës, shkrimtari: Do të shkruaj për historitë e kësaj treve**

19:45 **Alarm në SHBA, avion luftarak intercepton një avion mbi Camp David, aty ku po qëndronte Trump**

19:17 **Legalizimet dhe punësimi, komunitetet rome dhe egjiptiane kërkojnë më shumë mbështetje në Korçë**

TESTIM

me figure ku paralajmëronen që do të shkojnë në burg. Dhe është fatale për popullin shqiptar që sot të përmendemi si dhunues. Ekzistenca e Kosovës nuk vendoset në rrezik, gjithsesi, pavarësisht se Serbia do ta përdorë vendimin në favor të saj. Evropa na ka dëmtuar gjithmonë, që nga viti 1987, në Kongresin e Berlinit, ku iu dha kredi Greqisë dhe Serbisë për të na copëtuar", tha ai.

Vendimi i Hagës, asist për Vuçiçin, Buzhala: Serbia do të nisë fushatë për tërheqjen e njohjeve të Kosovës

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT | RAJONI | REVIEW

### Dënimi i krerëve të UÇK-së, Çipa: Proces politik, vendimi të lexohet nga të gjithë faktorët shqiptarë

I ftuar në "Review" me Greta Topjanën, analisti Aleksandër Çipa foli në lidhje me vendimin e Hagës për dënimin e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të...

21:21 | 19/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | RAJONI | REVIEW

### Vendimi i Hagës, asist për Vuçiçin, Buzhala: Serbia do të nisë fushatë për tërheqjen e njohjeve të Kosovës

Dënimi i krerëve të UÇK-së është një asist për presidentin serb Aleksandar Vuçiç, pikërisht në momentin kur ai ndodhet në fushatë zgjedhore. Kështu u shpreh...

21:05 | 19/09/2026

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT | RAJONI | REVIEW

### Buzhala: Gërvalla deklaronte se do të depozitonte fakte në Hagë, heshtja e saj pas vendimit është e pazakontë

Gazetari Berat Buzhala ishte i ftuar në një lidhje direkte për "Review" me Greta Topjanën, ku foli për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së dhe qëndrimin...

20:49 | 19/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.